



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA**

**Rr. Agim Ramadani, p.n., 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës Tel.:**  
**+381 38 220 294 \*E-mail: [arte@uni-pr.edu](mailto:arte@uni-pr.edu) [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)**

**Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Dega e Artit Vizual –Grafikë Me datë:14.10.2024** Temat mund të shikohen ne zyren nr. 104, prej dates 27/12/2024 deri 02/01/2025

Per kandidatet ne vijim:

<b>Nr.</b>	<b>Kandidati</b>	<b>Titulli I temës</b>	<b>Komisioni</b>
1.	Elirë Aliu	“N’kornizë”	1. Prof. Batri Mekolli-Mentor 2. Prof. Valdete Vuciterma-Kryetare e Komisionit 3. Prof. Bardhyl Bejtullahu-Anetar



FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA

UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”

---

Rr. Agim Ramadani, p.n., 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës Tel.:  
+381 38 220 294 \*E-mail: [arte@uni-pr.edu](mailto:arte@uni-pr.edu) [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

UNIVERSITETI PRISHTINES

“HASAN PRISHTINA”

Fakulteti i Arteve

Dega e Artit

Grafikë

Master i Artit – Specializimi: Grafikë

PUNIM DIPLOME

Tema :

“N’kornizë”

Mentori:

Prof. Bastri Mekolli

Kandidati:

Elirë Aliu

Prishtinë, 2024



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

Rr. Agim Ramadani, p.n., 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel.: +381 38 220 294 \*E-mail: [arte@uni-pr.edu](mailto:arte@uni-pr.edu) [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

### Abstrakt:

Gjatë periudhës së punës sime si artiste grafike, kam pasur mundësinë të shpreh forcën e femrës përmes artit. Për mua, grafika ka qenë një mjet për të thyer kornizat dhe për të sfiduar kufizimet që shoqëria, por edhe industria e artit, ka vendosur për femrat. Çdo punim ka qenë një hap drejt lirisë dhe një mënyrë për të shprehur vetveten si grua dhe si artiste, duke përdorur forcën e artit për të sfiduar të gjitha normat që më kanë kufizuar. Grafika për mua ka qenë shumë më tepër sesa një mjet krijues; ka qenë një mundësi për të shprehur botën time të brendshme dhe për të thyer çdo kufizim që është vendosur mbi gruan. Çdo skicim, çdo vepër ka qenë një përpjekje për të shkatërruar stereotipet dhe për të krijuar një hapësirë ku femra nuk është thjesht objekt, por një subjekt i fuqishëm që ka të drejtën të jetojë dhe të shprehë gjithçka që është. Teknikat që përdor kam mundur t'i formoj për të nxjerrë në pah forcën dhe lirinë që ndiej çdo ditë në krijimtarinë time.

Në çdo punim timin, femra ka një rol të veçantë. Ajo nuk është thjesht një figurë që zë një vend në një kompozicion, por një entitet që transmeton forcë, ndjenjë dhe liri. Kur krijoj, unë shpesh shpreh emocione dhe mendime që lidhen me përvoja personale, duke përdorur përmes grafikës figura të femrës që janë të fuqishme dhe që nuk përbahen nga kufizimet tradicionale. Kjo ka qenë një formë çlirimi për mua si grua, dhe një mundësi për të sfiduar çdo ide të ngurtë mbi rolin e gruas në shoqëri. Në shumë raste, arti ka qenë mënyra ime për të shkatërruar stereotipet që shoqëria ka për femrën. Grafika ishte ajo që hap pas hapi më ka mundësuar të përqendrohem në sfidimin e këtyre rregullave, duke paraqitur femrën si një figurë që është e lirë, e fuqishme dhe që ka të drejtën të krijojë pa kufizime. Çdo linjë dhe çdo lëvizje që kam përdorur ka pasur një qëllim të shkatërroj çdo koncept të vjetër që e lidhi gruan me pasivitetin dhe kufizimet. Fillimisht, kam hasur vështirësi për të pranuar se mund të isha një grua dhe një artiste e fuqishme në të njëjtën kohë, por grafika më ka ndihmuar të ndërtoj besimin në vetvete, dhe më ka dhënë mundësinë të kaloj nga momentet e dështimit në një ndjenjë të thellë fuqie dhe lirie. Çdo punim i ri është një hap më afër shkatërrimit të kufizimeve dhe afirmimit të vetes time si grua e pavarur.

Në fund, grafika ka qenë dhe vazhdon të jetë një pasqyrë e rrugëtimit tim personal dhe profesional. Puna ime ka qenë një mënyrë për të kaluar përmes sfidave dhe për të arritur një formë lirie që lidhet drejtpërdrejt me eksperiencat e mia si grua dhe si artiste. Unë besoj se femrat mund të vazhdojnë të sfidojnë kufizimet dhe barrierat që ekzistojnë ende në art, dhe se arti është një mjet i fuqishëm për të përçarur mesazhe të ndryshimit dhe lirisë.



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**

---

## Abstract:

During my career as a graphic artist, I have had the opportunity to express the strength of women through art. For me, graphic has been a tool to break boundaries and challenge the limitations that society, as well as the art industry, have placed on women. Each artwork has been a step toward freedom and a way to express myself both as a woman and as an artist, using the power of art to challenge all the norms that have restricted me. Graphic, for me, has been much more than just a creative tool; it has been an opportunity to express my inner world and to break every limitation imposed on women. Every sketch, every piece of work has been an attempt to destroy stereotypes and create a space where women are not just objects, but powerful subjects with the right to live and express everything they are. The techniques I use have allowed me to highlight the strength and freedom I feel every day in my creativity.

In each of my works, women have a special role. They are not just figures occupying a space in a composition, but entities that convey strength, emotion, and freedom. When I create, I often express emotions and thoughts linked to personal experiences, using the figure of women in my graphics who are strong and not bound by traditional limitations. This has been a form of liberation for me as a woman and an opportunity to challenge any rigid ideas about the role of women in society. In many cases, art has been my way of destroying the stereotypes that society has about women. My graphic work has been a step-by-step process that has allowed me to focus on challenging these rules, presenting women as figures who are free, powerful, and entitled to create without restriction. Every line and every movement I have made has had a purpose: to destroy any old concept that associated women with passivity and limitation.

At first, I had difficulty accepting that I could be both a woman and a powerful artist at the same time. But my work has helped me build self-confidence and has given me the opportunity to move from moments of failure to a deep sense of power and freedom. Every new work is a step closer to breaking down limitations and affirming my identity as an independent woman.

In the end, graphic has been and continues to be a reflection of my personal and professional journey. My graphic work has been a way to navigate challenges and reach a form of freedom that is directly linked to my experiences as both a woman and an artist. I believe that women can continue to challenge the limitations and barriers that still exist in art, and that art is a powerful tool for conveying messages of change and freedom.



**FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA**

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"**

---